



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 1401 / Prot.
5

Tiranë, më 28 / 03 / 2023

URDHËR

Nr. 226 datë 28 / 03 2023

**“PËR DHËNIEN E MASËS DISIPLINORE VËREJTJE ME PARALAJMËRIM PËR
HEQJEN E LICENCËS PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË NOTERIT DHE
GJOBË NË MASËN 200 000 LEKË, NOTERIT SAMI DERVISHI”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të shkronjës “a” dhe “b”, të pikës 2, pikës 3, pikës 4 si dhe pikës 5, të nenit 26, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ:

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 143, datë 19.04.2022 “Për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm pranë noterit Sami Dervishi”, grupi i inspektimit në datë 21.04.2022, ushtroi kontroll pranë zyrës së noterit Z. Sami Dervishi.

Në përfundim të analizës ligjore të akteve dhe veprimeve noteriale, objekt i kontrollit administrativ, grupi i inspektimit ka përfunduar raportin nr. 1401/1 prot., datë 27.02.2023 “Për kryerjen e kontrollit në zyrën noteriale të noterit publik Sami Dervishi”.

Me shkresë nr. 1401/1 prot., datë 01.03.2023, noterit Sami Dervishi i është përcjellë për njohje raporti nr. 1401/1 prot., datë 27.02.2023 “Për kryerjen e kontrollit në zyrën noteriale të noterit publik Sami Dervishi”, duke kërkuar dërgimin e argumentave dhe kundërshtimeve mbi gjetjet e këtij raporti jo më vonë se 10 ditë nga njoftimi.

Me shkresën e protokolluar pranë nesh me nr. 1401/3 prot., datë 13.03.2023, nga noteri Sami Dervishi janë paraqitur observacionet e tij lidhur me gjetjet e grupit të inspektimit, relatuar në raportin nr. 1401/1 prot., datë 27.02.2023 “Për kryerjen e kontrollit në zyrën noteriale të noterit publik Sami Dervishi”.

Nga analiza e pretendimeve paraqitur nga noteri Sami Dervishi konstatohet se kundërshtimet dhe argumentet e tij, referohen jo në pjesën e gjetjeve/shkeljeve kryesore referuar në raport, por në aspekte jo thelbësore.

Struktura e monitorimit të veprimtarisë noteriale vlerëson se pretendimet/kundërshtimet e paraqitura nga noteri Sami Dervishi, nuk paraqesin prova të reja të mjaftueshme për të mbështetur kërkesën për ndryshimin e masës disiplinore propozuar nga grupi i inspektimit.

Në përfundim të analizës ligjore të akteve dhe veprimeve noteriale, objekt i hetimit disiplinor, pasi u morën në vlerësim argumentat dhe kundërshtimet e paraqitura nga noteri, në raport me gjetjet e relatuar në raportin “Për kryerjen e kontrollit në zyrën noteriale të noterit publik Sami Dervishi”, vlerësohet se:

1. Lidhur me verifikimin e regjistrit të përgjithshëm i akteve dhe veprimeve noteriale dhe të tarifave përkatëse, konform ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr. 23, datë 07.12.2020 “Për evidentimin, administrimin, ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale dhe për organizimin, funksionimin dhe ruajtjen e arkivave noterialë, përfshirë formatin e tyre, si dhe formën, përmbajtjen, verifikimin e rregullueshmërisë dhe administrimin e regjistrave të veprimtarisë noteriale” rezulton se:

– Mbyllja e vitit të regjistrave dhe akteve noteriale nuk shënohet me vizë të kuqe, sipas parashikimeve të akteve nënligjore në fuqi.

– Rezultojnë 2 regjistra testamentesh, ku regjistri i parë periudha 2004 – 2007 është plotësuar vetëm në 4 faqe (nuk ka vulë nga Ministria e Drejtësisë për mbylljen e këtij regjistri), ndërkohe ka filluar regjistrin e ri të testamenteve, me nr. rendor vijues (ndërkohë që evidentohet se regjistrin e ri e ka marrë në dorëzim në vitin 2005) rezulton nga vula e Ministrisë së Drejtësisë. Rezulton se nga noteri ka vijuar me hedhjen e të dhënave në regjistrin e parë (pa vulën e Ministrisë së Drejtësisë) dhe pas dy vitesh pasi ishte pajisur me regjistrimin e ri të testamenteve.

– Gjithashtu lidhur me plotësimin e regjistrave të përgjithshëm të akteve dhe veprimeve noteriale si dhe regjistrit të testamenteve, nga noteri u deklarua se plotësoheshin nga sekretarja e tij, fakt i cilësuar në kontratë e punës, fakt i pranuar dhe nga vetë noteri.

Në zbatim të pikës 4 të Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr. 23, datë 07.12.2020 “Për evidentimin, administrimin, ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale dhe për organizimin, funksionimin dhe ruajtjen e arkivave noterialë, përfshirë formatin e tyre, si dhe formën, përmbajtjen, verifikimin e rregullueshmërisë dhe administrimin e regjistrave të veprimtarisë noteriale”, “Noteri është përgjegjës për çdo dëmtim të dokumenteve arkivore, që është shkaktuar nga mosrespektimi i detyrimeve të parashikuara në këtë udhëzim dhe mban përgjegjësi disiplinore.”

2. Lidhur me verifikimin e respektimit të detyrimit të noterit për hedhjen në sistem të akteve noteriale, në zbatim të VKM-së nr. 304, datë 21.05.2014, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të shërbimit Noterial Shqiptar, Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH)” rezulton se:

– Sistemi ishte funksional por përdorej nga ana e punonjësës Klaudja Tartari, fakt i pranuar dhe nga vetë noteri.

– Gjithashtu rezultoi se nga verifikimi i kryer në sistemin RNSH, në raport me regjistrat fizik të testamenteve, nuk korespondon numri i aktit të fundit hedhur në RNSH pasi në regjistrin fizik rezulton me nr. 435 ndërkohë që në RNSH, është regjistruar me nr. 437.

3. Lidhur me verifikimin e kontratës së sigurimit për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, sipas parashikimit të nenit 65, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, rezulton se:

Nga ana e noterit u vendos në dispozicion vetëm Polica e Sigurimit të Përgjegjësisë Profesionale nr. 20224, date 01.04.2022, me periudhë sigurimi 01.04.2022 – 31.03.2023. Nga grupi i inspektimit u kërkuan periudhat e tjera të sigurimit profesional, ku nga ana e noterit u deklarua se nuk kishte.

Neni 25 i ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë” i ndryshuar (i shfuqizuar) parashikon se “Noteri është i detyruar të lidhë kontratë sigurimi për veprimtarinë e tij noteriale sipas kritereve të caktuara në ligj.”

Neni 65, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, parashikon se “1. Noteri, përpara fillimit të ushtrimit të funksionit, lidh kontratë sigurimi të përgjegjësisë profesionale me një kompani sigurimi vendase ose të huaj që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë individuale ose bazuar mbi një kontratë kolektive të lidhur midis Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe kompanisë së sigurimit, për të gjitha dëmet që ai mund t’u shkaktojë klientëve apo palëve të treta gjatë ushtrimit të funksioneve të tij....”

Nga verifikimet e kryera rezulton se Polica e Sigurimit të Përgjegjësisë Profesionale është lidhur në datë 01.04.2022. Nga ana e noterit nuk rezulton që për periudhën objekt sipas këtij inspektimi, 2018-2022 të jetë lidhur Policë Sigurimi e Përgjegjësisë Profesionale çka lë të ekspozuar ndaj risqeve, subjektet për të cilat ky noter ka hartuar/lëshuar akte.

Në këtë kontekst, duke qenë se periudha objekt inspektimit 2018-2022 ka qenë e pambuluar me Policën e Sigurimit Profesional, vlerësojmë se ky noter është pjesërisht subjekt i parashikimeve të nenit 21, pika 1/g të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar.

4. Lidhur me ankesën e shtetases Shpresa Shushku transmetuar nga emisioni Fiks Fare nga grupi i inspektimit u administruan aktet sa vijon dhe u informacioni nga noter, duke konkluduar sa vijon:

Lidhur me pretendimet që ngre ankuesja, për aq kohë sa është shprehur gjykata sa i përket këtij rasti, Ministria e Drejtësisë vlerëson situatën në raport me sjelljen etike nga ana e noterit pasi për pretendimet e tjera nuk mund të shprehem për aq kohë sa është shprehur gjykata me Vendim nr. 13-2021-2200(633), datë 17.01.2021 e cila ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. 1178 të vitit 2020 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për veprën penale “Falsifikimi i dokumentave” parashikuar nga neni 186 i K. Penal.

Sa i përket Kodit të Etikës vlerësojmë se noter i gjendet në kushtet e shkeljes disiplinore sipas pikës 1/b të nenit 26 të ligjit 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar dhe pikës b të nenit 25 të Kodit të Etikës Profesionale të Noterit, miratuar me Urdhër nr. 444, datë 30.09.2019 nga Ministri i Drejtësisë, ku sanksionohet se: “Parashikohen si shkelje të lehta, të cilat sanksionohen me gjobë, detyrimin e kryerjes së trajnimeve në lidhje me çështjet e etikës profesionale ose detyrimin e plotësimit të trajnimeve të formimit vazhdues profesional, shkeljet e mëposhtme: b) sjellja joetike e një noter kundrejt institucioneve publike ose private, sipas nenit 22 të këtij Kodi;”.

5. Lidhur me verifikimin e Verifikimi i Aktit Nr.97 Rep, datë 19.01.2018 “Vërtetim njësie me origjinalin”, nga verifikimet e kryera rezulton se përkthyesja Drilona Rami është e licensuar nga Ministria e Drejtësisë dhe figuron në listën e gjuhës Greke, por në akt evidentohet se vula e noterit nuk ka përcaktimet e miratuara me akt nënligjor nga Ministria e Drejtësisë (çka përbën indicie për përdorim të dy vulave).

6. Lidhur me Verifikimi i Aktit Nr.674 Rep, datë 30.04.2021 “Vërtetim njësie me origjinalin” dhe aktin nr. 675 Rep, datë 30.04.2021 “Vërtetim njësie me origjinalin”, nga verifikimet e kryera në akt rezulton se përkthyesja Elda Leka për gjuhën greke nuk është e licensuar nga Ministria e Drejtësisë (pasi nuk figuron në listë e përkthyesve zyrtarë).

7. Lidhur me verifikimin e Aktit nr. 300 rep., 146 kol., datë 06.03.2018 “Kontratë Qiraje”, rezulton se akti është vulosur me dy vula të njoma, të ndryshme për nga forma (njëra sipas specifikimeve në aktet nënligjore nga Ministria e Drejtësisë, tjetra jo).

Në këto kushte, duke qenë se evidentohen shkelje thelbësore referuar gjetjeve në raport, rrjedhimisht masa disiplinore e përcaktuar është në proporcion me shkeljen e kryer.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të shkronjës “a” dhe “b”, të pikës 2, pikës 3, pikës 4 si dhe pikës 5, të nenit 26, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit të noterit dhe gjobë në masën 200 000 lekë”, noterit Sami Dervishi, anëtar i Degës Vendore të Noterisë Durrës.
2. Noteri Sami Dervishi të marrë të gjitha masat për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, që lidhen me ushtrimin e rregullt të veprimtarisë noteriale, sipas parashikimeve të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.
3. Ky Urdhër t’i njoftohet menjëherë Noterit Sami Dervishi, Degës Vendore të Noterisë Tiranë, Dhomës Kombëtare të Noterisë, si dhe ankuesve.
4. Ndaj këtij urdhri, noteri mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij
5. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI


Ulsi Manja

